



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.01.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Besa Security" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Besa Security" e datës 15.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 01.03.2021, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi i Autoritetit Kontraktues i publikuar me datë: 01.03.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë respektimin e Vendimit të datës 01.03.2021
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Besa Security" me datë 01.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.01.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


-Se pari ua sqaroi se sipas Njoftimit të Autoritetit Kontraktues ju nuk jeni pale e interesit sepse në periudhat paraprake ju nuk keni bërë vazhdimin e vlefshmerisë së ofertes si që është kërkuar nga ju dhe tenderuesit tjerë. Por edhe perkunder kësaj për korektesi ju sqarojmë se të gjitha pretendimet tuaja janë sqaruar në Vendimet paraprake.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet e paraqitura më lartë vendosi si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit